

RREGULLORE NR. 2000/31

**NDRYSHIM I RREGULLORES NR. 2000/5 PËR CAKTIMIN E TAKSËS SË SHËRBIMIT
PËR HOTELE, USHQIM DHE PIJE**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimet që i janë dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1, të ndryshuar, të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Pas shpalljes së Rregullore nr. 2000/5 të 1 shkurtit 2000 mbi caktimin e taksës së shërbimit për hotele, ushqim dhe pije,

Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të efikasitetit të taksës së shërbimit për hotele, ushqim dhe pije,

Me këtë ndryshon nenet 2, 8 dhe 9 i Rregullore së UNMIK-ut nr. 2000/5.

Rrjedhimisht, rregullorja do të ketë formulimin e mëposhtëm si të datës kur kjo Rregullore hyn në fuqi:

RREGULLORE NR. 2000/5

PËR CAKTIMIN E TAKSËS SË SHËRBIMIT PËR HOTELE, ushqim dhe pije

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimet që i janë dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren nr. 1999/16 të UNMIK-ut të datës 6 nëntor 1999, të ndryshuar, mbi Organin Qendror Fiskal të Kosovës dhe çështje të tjera lidhur me të,

Me qëllim të caktimit të taksës së shërbimit për hotele, ushqim dhe pije

Shpall sa vijon:

Neni 1
Përkufizimet

Sipas kësaj Rregulloreje:

1.1 “Hotel” do të thotë çdo ndërmarrje në Kosovë e cila, me qëllim të realizimit të profitit, lëshon me qira dhoma fjetjeje dhe u ofron shërbime përkatëse personave që vendosen në këto dhoma si klientë hoteli. Me “klientë hoteli” nënkuptohen të gjithë ata persona, qëndrimi i të cilëve në dhoma të tilla nuk tejkalon gjashtë muaj.

1.2 Me “Ndërmarrja për ushqim dhe për pije” nënkuptohet çdo ndërmarrje punuese në Kosovë me kapacitet pranues (qoftë në ambient të brendshëm, të jashtëm apo kombinim i të dyjave) ku ushqimi apo pijet u shërbehen klientëve për konsumim, aty apo në ndonjë vend tjetër, në këmbim të pagesës me të holla apo në ndonjë mënyrë tjetër për të realizuar fitim.

Neni 2

Taksa e shërbimit për hotele, ushqim dhe pije

Çdo ndërmarrje hoteliere për ushqim apo për pije, që realizon të ardhura mujore mbi 10.000 DM bruto në cilindo muaj kalendarik, do t’i nënshtrohet taksës së shërbimit të hoteleve, ushqimit dhe pijeve (“taksës së shërbimit”) për atë muaj dhe për çdo muaj që pason në atë vit kalendarik. Kriteret për të vendosur nëse të ardhurat bruto të një ndërmarrjeje hoteliere për ushqim apo pije e tejkalojnë atë shumë do të përcaktohen në udhëzimin administrativ, që do ta lëshojë udhëheqësi i Organit Qendror Fiskal.

Neni 3

Tarifa e taksës së shërbimit

Tarifa e taksës së shërbimit që paguhet sipas kësaj Rregulloreje është dhjetë (10%) për qind mbi të ardhurat bruto për çdo muaj kalendarik.

Neni 4

Mbajtja e shënimeve

Çdo ndërmarrje hoteliere për ushqim apo për pije, që i nënshtrohet taksës së shërbimit në cilindo muaj kalendarik, duhet të mbajë shënime me shkrim për atë muaj dhe çdo muaj që pason në atë vit kalendarik, në përputhje me udhëzimet administrative që do t’i lëshojë Udhëheqësi i Organit Qendror Fiskal.

Neni 5

Paraqitja dhe pagimi i tatimit

Çdo ndërmarrje hoteliere për ushqim apo për pije, që i nënshtrohet taksës së shërbimit duhet ta paraqesë tatimin dhe të paguajë taksën e shërbimit brenda një afati prej 15 ditësh pas ditës së fundit të muajit kalendarik për të cilin duhet të paguhet tatimi. Udhëheqësi i Organit Qendror Fiskal do të lëshojë udhëzime administrative që përfshijnë informatat e duhura lidhur me paraqitjen e tatimit, metodën e llogaritjes së taksës së shërbimit që duhet paguar dhe procedurat e pagimit të taksës së shërbimit.

Neni 6

Inspektimi i shënimeve

Zyrtarët tatimorë, të autorizuar nga Drejtori i administratës për tatim, mund t’i inspektojnë të gjitha shënimet dhe dokumentet e tjera që kanë të bëjnë me ndërmarrjet hoteliere, për ushqim dhe për pije, për të konstatuar se a veprohet në përputhje me këtë Rregullore.

Neni 7
Derdhja e të hyrave

Të hyrat që realizohen nga taksa e shërbimit depozitohen në Fondin e Konsoliduar të Kosovës.

Neni 8
Shkeljet dhe gjobitjet

Çdo ndërmarrje hoteliere për ushqim apo për pije, që bën shkelje tatimi, siç është përkufizuar me Rregulloren nr. 2000/20 mbi Procedurat dhe Taksën Administrative, do t'i nënshtrohet gjobitjeve të përcaktuara në pajtim me atë Rregullore.

Neni 9
Ankesat

Çdo ndërmarrje hoteliere për ushqim apo për pije, që mendon se ndonjë vendim zyrtar i bërë sipas kësaj Rregulloreje është i padrejtë, mund të ankohet kundër një vendimi të tillë në pajtim me procedurat e përcaktuara me Rregulloren 2000/20 Mbi Procedurat dhe Taksat Administrative dhe urdhëresat administrative të lëshuar në përputhje me të.

Neni 10
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë urdhëresa administrative në lidhje me zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 11
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që ka të bëjë me taksat e shërbimit për hotele, ushqim apo pije, e që është në kundërshtim me të.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn[1] në fuqi më 1 shkurt të vitit 2000.

Kjo rregullore hyn në fuqi më 23 maj të vitit 2000.

Bernard Kouchner
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

[1] Rregullorja origjinale